

## BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Fjala e Guvernatorit Gërguri në Konferencën me gazetarë lidhur me Raportin Vjetor të BQK-së për vitin 2010, mbajtur më 03 gusht 2011.

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Sot para jush po prezantojmë aktivitetet kryesore të përfshira në Raportin Vjetor të BQK-së për vitin 2010 dhe po japim një përmbledhje të zhvillimeve kryesore në gjysëmvetorin e parë të këtij viti.

Raporti nënvizon vazhdimin e rritjes pozitive të ekonomisë së Kosovës gjatë vitit 2010, rritje kjo që vazhdon të përshkohet me një sektor privat dinamik i shoqëruar me një kujdes për stabilitet financiar dhe makroekonomik. Në mënyrë të sintetizuar portreti i ekonomisë kosovare në vitin 2010 pati këtë pamje:

- sektori financiar reflektoi stabilitet dhe shëndet të mirë - në veçanti, sistemi bankar tregoi nivel të lartë të kapitalizimit, cilësi të mirë të portofolit kreditor dhe gjendje të kënaqshme të likuiditetit. Kjo qëndrueshmëri u konfirmua edhe nga “stres-testi” i sistemit bankar, me ç’rast sistemi bankar reflekton të jetë rezistent – në gjendje të përballojë edhe tronditje serioze, të cilat janë supozuar në shembuj hipotetik;
- edhe pse ndërmjetësimi financiar vazhdoi me rritje, nuk pati ndryshime për sa i përket shkallës së kostos së ndërmjetësimit;
- inflacioni u rrit, ndërsa trendi rritës e përcolli edhe inflacionin në zonën e euros;
- ndërsa, deficitet buxhetor bashkë me borxhi publik i jashtëm mbeten në nivele modeste shprehur në përqindje të PBB-së;

Zhvillimet e theksuara në këtë raport dhe ato të cilat do prezantohen nga stafi profesional reflektojnë sfidat me të cilat përballlet ekonomia e Kosovës. Rrjedhimisht, konsiderojmë se ndër përgjigjet ndaj këtyre sfidave janë ato që ndërliken me dinamizimin e aktiviteteve që kanë të bëjë me:

- përmirësimin e mëtejshëm të ambientit për biznes (jo vetëm për të joshur investitorë nga jashtë, por për të nxitur njësoj edhe investimet e brendshme);
- gjenerimin e kapaciteteve planifikuese dhe të vendimmarrjes së përgjegjshme të akterëve në sektorin publik dhe privat (konsolidimi makroekonomik duhet të reflektojë optimalizimin dhe harmonizimin e nevojave ndërsektoriale dhe ndërinstucionale);
- institucionalizimin e infrastrukturës mbi raportimin e pavarur dhe të përgjegjshëm financiar të aktiviteteve ekonomike relevante – i rëndësishëm për shfrytëzim edhe më efektiv dhe më efikas të benefiteve të sektorit financiar si alokues më racional i kursimeve drejt sektorëve konkurrues të ekonomisë;
- një koordinim edhe më efektiv midis institucioneve dhe midis agjentëve të tregut.

Të gjitha këto përbëjnë pikënisje me rëndësi për rishikimin dhe përmirësimin e nevojshëm të modelit të zhvillimit ekonomik të deritashëm të Kosovës i cili duhet të orientohet kah sektori i prodhimit.

\*\*\*

Unë nuk do elaboroj të dhënat sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë sepse ato do t'i keni në detaje gjatë prezantimit që pason, mirëpo kisha shfrytëzuar rastin që në mënyrë telegrafike të nënvizoj edhe pjesën tjetër të performancës së BQK-së që ka të bëjë me shërbimet që ajo i ofron për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun.

Krahas sigurimit të stabilitetit financiar, BQK-ja ka vazhduar me ngritjen e cilësisë së furnizimit me kartëmonedha dhe monedha euro, ndërsa investimi i mjeteve të BQK-së u shoqërua me siguri të lartë, likuiditet të mjaftueshëm dhe kthim të arsyeshëm në investime. Sistemi i pagesave në kleringun ndërbankar shënoi rritje si në numër ashtu edhe në vlerë të transaksioneve të kryera gjë që flet për trendin e rritjes relative të pagesave pa para të gatshme.

Aktivitetet me rëndësi në fushën e statistikave dhe analizës ekonomike e financiare kishin të bëjë me fillimin e dërgimit të statistikave të bilancit të pagesave në FMN në frekuencë tremujore. Krahas publikimeve të rregullta, vitin 2010 e karakterizoi publikimi i numrit të parë të Raportit mbi Stabilitetin Financiar në Kosovë. Progres konkret u shënua edhe në fushën e realizimit të “stres – testit” për sektorin bankar, përfshirë këtu standardizimin e Indikatorëve të Paralajmërimit të Hershëm të cilët hartohen në baza të rregullta mujore.

Bashkëpunimi, promovimi dhe përfaqësimi ndërkombëtar: në vitin 2010 BQK-ja nënshkroi tre Marrëveshje Mirëkuptimi me autoritete të ngjashme ndërkombëtare – me Agjencitë për Mbikëqyrje të Sigurimeve të Malit të Zi dhe atë të Maqedonisë, si dhe me Komisionin për Mbikëqyrje Financiare të Bullgarisë. BQK-ja ishte organizatore dhe bashkorganizatore e konferencave/seminareve në tema me rëndësi për sektorin financiar dhe ekonominë vendit.

Burimet njerëzore vazhdojnë të jenë aset me rëndësi i BQK-së: BQK-ja e realizoi agjendën e saj me gjithsej 165 punëtorë gjë që flet për një kompetencë dhe produktivitet të personelit të saj. Ka vazhduar programi i trajnimeve të ndërlidhura me vendin e punës. BQK-ja sot ka 31 punëtorë me master (15 prej tyre me master nga jashtë), si dhe 6 kandidatë për doktor të shkencave ekonomike, kryesisht në universitetet jashtë Kosovës. Njëkohësisht, është hera e dytë që stafi i BQK-së fiton çmimin prestigjioz evropian “Olga Radzyner” i cili në konkurrencë të lartë u ndahet për çdo vit nga Banka Nazionale e Austrisë punimeve më të mira në fushën e ekonomisë dhe financave.

## **BQK në vitin 2011**

Krahas aktiviteteve standarde në drejtim të realizimit të detyrave dhe përgjegjësive të saj të përcaktuara me Ligjin e BQK-së, BQK-ja në vitin 2011 është fokusuar në veçanti në aktivitetet si në vijim:

Avancimi i kuadrit ligjor për sektorin financiar:

- Pas aprovimit të Ligjit mbi sigurimin e depozitave, është funksionalizuar Fondi për Sigurimin e Depozitave. Kjo pritet të përmirësojë maturitetin e depozitave në sistem.

- Tashmë është aprovuar edhe Ligji mbi sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë, ndërsa është nënshkruar Marrëveshja për themelimin e Byrosë Kosovare të Sigurimit si parakusht me rëndësi për aplikim për anëtarësim në Këshillin e Byrove të Kartonit të Gjelbër;
- Janë në përfundim e sipër: Ligji mbi sigurimet e përgjithshme; Ligji mbi licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave komerciale, institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare; Ligji mbi sistemet e pagesave; Ligji mbi pensionet në Kosovë.

Bashkëpunimit bilateral me autoritetet prej nga vijnë institucionet financiare që operojnë në Kosovë është avancuar me nënshkrimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit me Autoritetin Rregullativ Financiar të Gjermanisë (Bafin).

Gjithashtu, është ngritur shkalla e bashkëpunimit ndërinstitucional përbrenda vendit, natyrisht, kryesisht me Ministrinë e Financave, pastaj edhe me entitetet tjera si: Marrëveshja e nënshkruar me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Marrëveshja në përfundim e sipër për nënshkrim me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës.

Nën lidhshëpin e BQK-së, Republika e Kosovës, në prill të 2011 u bë shteti i 98-të që filloi pjesëmarrjen në Sistemin e Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme të Fondit Monetar Ndërkombëtar duke bërë kështu një hap të madh në zhvillimin e sistemit të statistikave.

Me kërkesën e BQK-së, në qershor të 2011-së janë realizuar dy misione ekspertësh të Bankës Botërore:

- misioni mbi Raportin e Observimit të Standardeve dhe Kodeve (ROSK) të qeverisjes korporative në sektorin bankar dhe atë mikrofinanciar, dhe
- misioni mbi ROSK-un e Josolvencës dhe rexhimit të kreditorëve/debitorëve në Kosovë.

Këtu vlen përmendur edhe projektin e zgjerimit dhe pasurimit të informacionit kreditor për Regjistrin e Kredive të Kosovës, mbështetur nga USAID.

Siç do të shihni edhe nga prezantimi në vijim, pikëpamja ekonomike për vitin 2011 është pozitive. Emërues i përbashkët i pikëpamjes së tillë është norma e pritjes së PBB-së prej 5%. Padyshim, sistemi bankar i qëndrueshëm do të vazhdojë të jetë ndër shtytësit me rëndësi të kësaj rritjeje. Ne besojmë se inkurajimi i hyrjeve të reja në sektorin bankar, pastaj kompletimi i infrastrukturës për tregun e letrave me vlerë si dhe implementimi i rekomandimeve që dalin nga raportet e lartcekura (ROSK) padyshim se do të krijojnë një ambient më të favorshëm jo vetëm për rritjen e mëtejme të kredidhënies, por edhe për zvogëlim të kostos së kredidhënies e me këtë për një kontribut më të madh të sektorit bankar në zhvillimin e ekonomisë së vendit tonë.

\*\*\*\*

Ju falemnderit!